



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 24.03.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe
Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu,
Doruntinë Maloku, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Nezir Çoçaj.

Munguan: Donika Kadaj-Bujupi, Fatmir Limaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Arton Demhasaj-Çohu;
Petrit Hysaj-OSBE; Valdet Hajdini-IKD; Florina Merovci-ZPRK; Adem Gashi-US Embassy;
Valmire Hoti-Infodirekt; Tv; _____-EUSR; Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office; Drilon
Asllani-Radio- Dukagjini; Mimoza Sadiku-Lajmi.net; Leotrim Berisha-Tribuna Chanel; Etleva
Ikonja-Kosova Sot; Skender Govori-BIRN; Valon Dobruna-Kuvendi.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02.03.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;

4. Shqyrtimi i propozimit të Odës së Avokatëve për emërimin e anëtarit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
5. Nisma e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02.03.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 02.03.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës

Kryetarja paraqiti vërejtjet që ka për projektligjin. Projektligji që është sjellë derivon nga një marrëveshje ndërkombëtare, për t'u kthyer kopjet kadastrave, që synon themelimin e një agjencie që shumë më tepër është ndërkombëtar, e jo vetëm në përbërje, por edhe në bazën juridike, financim të veçantë dhe funksionim jashtë ligjeve të Republikës së Kosovës. Nëse ky projektligj kalon, ashtu sikurse marrëveshja e Serbisë në çështjen e pranimit të kopjeve të dokumentacionit kadastral, në vend të origjinalit, Kuvendi do të legalizojë aktin e vjedhjes së dokumenteve të Kosovës dhe pronave të saj. Për një shtet sovran, si ligji ashtu edhe agjencia që derivon prej tij, janë absolutisht të panevojshme. Çështjet që vlejné të kundërshtohen në ligj janë: përbërja e agjencisë nga 5 anëtarë, ku 3 emërohen nga përfaqësuesi special i BE-së. Financimi, ku kompensimi nuk do të jetë i njëjti për gjithë anëtarët e bordit. Gjithashtu mbetet e mangët situata kur do të kemi ndeshje mes kopjeve kadastrave që vijnë nga Serbia dhe atyre që i posedon Kosova. Komisioni për verifikim të pronës nuk obligohet të marrë për bazë vendimet gjyqësore dhe administrative. Ankimimi për vendimet e këtij komisioni është i kufizuar, dhe madje edhe i kontrolluar, dhe kjo bie ndesh me parimet bazë të drejtësisë, pra kur kemi rast ankesë, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë vetëm përmes sekretarisë së kësaj agjencie. Gjithashtu paneli për të shqyrtuar këto ankesa do të jetë i veçantë në kuadër të Gjykatës Supreme, gjë që edhe kjo nuk është në rregull. Kufizimi tjetër që vjen është ai që ka të bëjë me moslejimin e shfrytëzimit të fakteve të reja nga ana e palëve, dhe gjatë interpretimit të ligjit Gjykata nuk obligohet t'i marrë për bazë dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore, por ato lihen në dispozicionin e gjykatës. Gjithashtu në dispozitat përfundimtare ka një kontradiktë ligjore, dhe ajo në nenin 31 dhe 26. Në nenin 26 thuhet se shtojcat 1, 2 dhe 3 të ligjit 03/L-079 do të shfrytëzohen deri në miratimin e akteve të tjera. Ndërsa në nenin 31 thuhet se me këtë ligj shfuqizohet edhe ligji i lartcekur. Ajo

ftoi anëtarët Komisionit që të jenë të vetëdijshëm për këto efekte që sjell ligji, dhe ta shqyrtojmë pikë për pikë si të tillë.

Armend Zemaj- Theksoi se dilema për kushtetutshmëri të ligjit ka qenë edhe në mandatin e kaluar, dhe se kemi pasur dilema ngase me përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë, është diskutuar edhe roli i faktorit ndërkombëtar. Ne kemi marrë obligime nga marrëveshjet e nënshkruara, andaj, duhet të jemi më koshient në hapa që i marrim, të shikojmë në mënyrë më përmbajtjesore, dhe të ecim më tutje. Ne kemi keqpërdorim të aspektit të pronave në Kosovë, dhe prona shoqërore është keqpërdorë nga individ, dhe sot kemi nevojë që t'i krahasojmë ato akte të vjetra dhe kjo është në të mirë të qytetarëve që sa më shpejt ai dokumentacion të jetë i pranishëm këtu. Ai propozoi që të ftohet zonja Edita Tahiri për një tjetër shpjegim, dhe të procedojmë në afate të shkurtra që ne të mos bëhemi pengesë si Komision për realizimin e obligimeve që ka marrë Qeveria. Ndërsa sa i përket përmirësimeve në projektligj, është e rrugës që pas leximit të parë, dhe mendimeve nga grupet parlamentare dhe deputetët, ne, si Komision, të ulemi dhe t'i bëjmë ato në mënyrë që mos të na paraqiten paqartësi të mëtutjeshme. Andaj, mendoj se Komisioni duhet ta procedojë tutje këtë projektligj, dhe t'i lihet seancës që të vendosë.

Kryetarja në lidhje me këtë theksoi se në mandatin e kaluar ne patëm rekomanduar që të mos votohet ngase bie ndesh me kushtetutën, por pavarësisht këtij fakti seanca e pati votuar. Andaj, unë pajtohem plotësisht që të ftojme ne Komision zonja Edita Tahiri që të paraqes qëndrimet për projektligjin.

Selvije Halimi- Theksoi se problemi me pronat në Kosovë daton edhe para periudhës së luftës, dhe se viktimë kryesore në këtë kanë qenë dhe janë shqiptarët. Ajo gjithashtu theksoi se prolongimi i miratimit të projektligjit vetëm se do të ngatërronte gjërat më shumë, andaj është e rrugës që kjo të bëhet sa më parë. Andaj, ajo propozoi që ligji të miratohet në parim, të dërgohet në Kuvend, dhe më pas të formohet në grup punues dhe të merr parasysh të gjitha vërejtjet që mund të dalin për projektligjin, por të kemi edhe përfaqësues relevant në Komision që do të mund të sqaronin për projektligjin. Sa i përket kopjeve të kadastrave, ajo theksoi se as vetë personalisht e asnjë qytetar i Kosovës nuk pajtohet që ato të jenë të tilla, por konsideroi se ato do të shërbejnë për punë të përkohshme ngase herët apo vonë origjinali i tyre do të kthehet në Kosovë, ngase mbajtja e tyre në një shtet tjetër është e padrejtë.

Agim Aliu- Theksoi se pavarësisht vërejtjeve që u thanë për projektligjin, e që janë me vend, nuk do të ishte e arsyeshme që kjo çështje të zgjatet edhe më tutje. Ai tha se si Komision duhet larguar përgjegjësinë e mbajtjes peng të qytetarëve, ngase është edhe obligim yni që t'u ofrohet zgjidhje sa më parë atyre. Andaj, ai propozoi që projektligji si i tillë të miratohet në parim, të dërgohet për seancë në Kuvend, dhe pas votimit atje, në të procedojmë me grupe punuese dhe gjithçka na shërben në drejtim të përmirësimit dhe përgatitjes së një drafti sa më profesional.

Agim Ademaj- Theksoi se pajtohet me atë që projektligjin ta miratojmë në parim dhe ta dërgojmë në seancë, dhe më pas në mes të dy leximeve të përmirësohen vërejtjet e mundshme.

Nezir Çoçaj- Theksoi se nuk është që të ftohet zonja Edita Tahiri për të dhënë sqarime, ngase konsideroi se ato janë thënë më parë, por ai propozoi që të procedohet në seancë, dhe ndoshta në mes të dy leximeve të punohet për të përmirësuar gjërat që mund të përmirësohen. Ai theksoi se ka dilemat e njëjta që u thanë këtu, por konsideroi se kjo është çka Komisioni mund të bëjë për momentin.

Pas diskutimeve, Komisioni me 7 (shtatë) vota; 6 vota për dhe 1 (një) kundër, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës.

4. Shqyrtimi i propozimit të Odës së Avokatëve për emërimin e anëtarit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja- Theksoi se sa i përket propozimit të Odës së Avokatëve ai prapë mbetet i njëjti me vetëm një emër, andaj konsideroi se ky institucion nuk është duke përfillur kërkesën e Komisionit për të propozuar 3 (tre) e më shumë persona.

Nezir Çoçaj- Theksoi se qëndron prapa asaj që ka deklaruar më herët që propozimi i Odës së Avokatëve me vetëm një person të dërgohet në seancë për votim, ngase konsideron si një lloj ndërhyrje në këtë institucion me vetë insistimin e Komisionit për të dërguar më shumë emra.

Dorunitë Maloku- Theksoi se duhet të insistojmë që Oda e Avokatëve ta përfillë kërkesën tonë, dhe të sjellë në Komision më shumë se një kandidatë, ngase në këtë mënyrë do të kemi më shumë zgjidhje për të zgjedhur anëtarin për Këshill Gjyqësor.

Kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni ripërsëriti kërkesën që Oda Avokatëve të propozojë emra shtesë (së paku tre), për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

5. Nisma e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetarja- Theksoi se në lidhje me plotësim-ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nismë e marr nga ana e Komisionit, me propozimin e Avokatit të Popullit, për të hequr kufizimin kohor, që ai institucion të paraqesë para Gjykatës Kushtetuese kushtetutshmërinë e akteve ligjore me karakter të përgjithshëm, është mirë të formohet grupi punues.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

1. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, vendosi që të hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
2. Themelohet grupi i punës në përbërje: Selviqe Halimi, kryesuese, Albulena Haxhiu dhe Danush Ademi, anëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
